



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIJË
DHE ENERGJISË

Nr. 5449/prot.

Tiranë, më 22. 7. 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1741 datë 10.02.2015.

SHOQËRISË "KAPAJ" SH.P.K

Frakull e Madhe, Fier

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Kapaj" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1741, datë 10.02.2015, për mineral konglomerate, në objektin "Frakull e Vogël", Fier.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5936, datë 01.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5449 datë 02.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1741, datë 10.02.2015, për mineral konglomerate, në objektin "Frakull e Vogël", Fier, për arsye se nuk është kryer pagesa e diferencës së garancisë së investimit në shumën 2 143 200 lekë, përcaktuar sipas pikës 3, të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe paragrafit të III-të të VKM nr.741, pika 2, që ka dalë në zbatim të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1741, datë 10.02.2015, për mineral konglomerate, në objektin "Frakull e Vogël", Fier, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1741 datë 10.02.2015, për mineral konglomerate, në objektin "Frakull e Vogël", Fier.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet mineral.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

